

Raporti vjetor 2013

Janar 2014



Adresa: *Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë*

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Përmbajtja:

- Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare..... 3
- Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional 4
- Programi i trajnimit për vitin 2013 6
- Procesi i Trajnimit.....6
- Vlerësime dhe të Dhëna të Përgjithshme8
- Mbështetje Institucionale dhe Financiare9
- Bashkëpunimi me Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare.....12
- Menaxhimi financiar.....14
- Vlerësime të përgjithshme.....14



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Realizimi i planit të trajnimit në mbështetje të prioriteteve të Qeverisë Shqiptare

Viti 2013 është viti në të cilin është ndërthurur veprimtaria e Institutit të Trajnimit të Administratës Publike (ITAP) dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Në periudhën Janar- Prill 2012, aktivitetet trajnuese janë zhvilluar nga ITAP, dhe më pas me hyrjen në fuqi të Vendimit Nr. 220 datë 13.02.2013, të Këshillit të ministrave ” Mbi zhvillimin dhe funksionimin e shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë” , u bë e mundur krijimi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) .

Në periudhën Janar- Prill veprimtaria e Instituti të Trajnimit të Administratës Publike është zhvilluar bazuar në planin strategjik 2011-2013, hartuar në përputhje ne objektivat strategjike të qeverisë si edhe në SKZHI-në që është baza për realizimin e planit të punës dhe vendosjen e objektivave institucionale.

Ndërsa në periudhën Prill- Dhjetor, ASPA ka zhvilluar veprimatrinë trajnuese bazuar në planet dhe aktivitetet e planifikuara nga ITAP, duke vënë në përdorim burimet, kurikulat dhe kapacitetet egzistuese. Fokusi kryesor i punës në këtë periudhë ka qënë rritja e kapaciteteve të administratës publike në drejtim të përgatitjes së vendit për anëtarësimin në Bashkimin European. Në këtë kuadër, është bashkëpunuar ngushtësisht më donator dhe programe si SMEI III, PPF etj, të cilat kanë qënë partnerët tanë në këto aktivitete.

E parë në këtë këndvështrim aktivitetet trajnuese janë orientuar:

Lufta kundër korrupsionit

Në prioritetet e qeverisë sonë ka qënë lufta kundër korrupsionit. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian vlerëson përpjekjet e ndërmarra dhe thekson një përmirësim të perceptimit të luftës kundër korrupsionit. Trajnimet e zhvilluara në këtë fushë kanë përfshirë si nivelin qendror edhe atë lokal , me tematikë “ Prokurimi elektronik i blerjeve të vogla” .

Në total janë zhvilluar 23 trajnime me këtë tematikë, përkatësisht 13 në nivel qendror dhe 10 në nivel lokal, dhe janë trajnuar 723 nëpunës civilë.

Decentralizimi

Gjatë vitit 2013 fokusi ka qënë thellimi dhe zgjerimi i procesit të decentralizimit të pushtetit vendor, përmes forcimit të nivelit të parë të qeverisjes vendore. Këtij qëllimi i kanë shërbyer trajnimet e organizuara me tematike “ Procesi i vendimarrjes dhe menaxhimi i stafit”, i zhvilluar në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Politike. Ky trajnim u hartua për drejtuesit e pushtetit vendor dhe nëpërmjet këtij programi, është synuar rritja më tej e njohurive dhe aftësive të drejtuesve të këtyre strukturave vendore. Gjatë vitit 2013 janë zhvilluar 2 trajnime në nivelin lokal dhe janë trajnuar 34 nëpunës civilë të niveli drejtues në administratën vendore.

Një vend të veçantë kanë zënë trajnimet në nivel lokal me temë:” Asistencë teknike për Administratën Publike Vendore lidhur me nënshkrimin elektronik dhe dokumentin elektronik , i organizuar me mbështjen e Fondacionit “ Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”- OSFA . Janë



Adresa: *Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë*

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

zhvilluar 10 trajnime në qytetet; Gjirokastrë, Sarandë, Korçë, Berat, Shkodër, Lezhë, Pogradec, Fier etj dhe janë trajnuar 259 nëpunës civilë të administratës lokale.

○ **Trajnime lidhur me procesin e Integrimit në Bashkimin Europian.**

Trajnimet që lidhen me procesin e integrimit Europian të Shqipërisë, ka qënë dhe mbetet një nga fushat më të rëndësishme të trajnimit të administratës publike. Në këtë kuptim, edhe gjatë vitit 2013, është punuar në vazhdimësi në bashkëpunim edhe me projektet si SMEI III e PPF për organizimin e trajnimeve në këtë fushë. Tematikat e trajnimeve kanë qënë: Menaxhimi i ciklit të projektit ; Hartimi i Termave të referencës (TOR) ; Prokurimi i punëve; Prokurimi i mallrave; Marrëveshja Kuadër; Prokurimi i shërbimeve, Politikat sektoriale të BE-së etj.

Gjatë vitit 2013 janë zhvilluar: 52 dite trajnimi dhe janë trajnuar 381 nëpunës civilë të nivelit qëndror, në 24 kurse trajnimi.

📌 **Objektivat kryesorë strategjikë të zhvillimit institucional**

Objektivat kryesorë strategjikë për vitin 2013, duke e bërë atë më aktiv në përmbushjen e vizionit dhe misionit të tij, janë si më poshtë:

✓ *Krijimi i një institucion të orientuar më shumë drejt klientit.*

Gjatë vitit 2013, ka qënë viti i fundit i zbatimit të strategjisë 2011-2013, vit i cili përkoj edhe më përfundimin e aktivitetit të ITAP-it , si edhe me krijimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Zhvillimi i aktiviteteve të institucionit është orientuar në dy drejtime kryesore:

1. Zbatimi i strategjisë duke zbatuar programin e trajnimit në përputhje me nevojat reale të Administratës Publike.
2. Krijimi dhe konsolidimi i ASPA-s, si institucion i ngritur në vazhdimësi të ITAP-it duke shfrytëzuar me efektivitet kapacitetet trajnuese dhe logjistike të tij.

Për realizimin e këtij objekti është punuar në disa drejtime:

- Përdorimin me efektivitet të kapaciteteve trajnuese dhe logjistike
- Forcimin e rolit dhe funksioneve të menaxherit të trajnimit
- Forcimin e kontrollit të cilësisë të zhvillimit të trajnimit
- Rritjen e kapaciteteve të brendshme, me qëllim përfshirjen e vetë stafit në zhvillimin e disa programeve bazike të trajnimit.

✓ *Përmirësimi i organizimit të brendshëm të Institucionit me qëllim ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin e trajnimeve në nivel strategjik, në kuadër të SKZHI-së dhe MSA –së.*



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Në kushtet kur nevojat për trajnim janë vazhdimisht në zhvillim, bazuar edhe në programet dhe reformat e ndërmarra nga Qeveria, është e rëndësishme të theksojmë se Institucioni (ITAP-ASPA) ka luajtur një rol të rëndësishëm duke marrë pjesë në diskutime e aktivitet duke këshilluar dhe mësuar nga komentet (feedback) si dhe ka hartuar dhe zbatuar plane afatgjata për rritjen e kapaciteteve.

- ✓ *Rritja e rolit të Institucionit në zhvillimin e programeve të trajnimit të financuara nga ndihma e huaj.*

Gjatë kësaj periudhe, është punuar në bashkëpunimin me projekte të financuara nga donatorë, duke dhe projekte: “Proect Preparation Facilities” PPF, “Support to the EU Integration Process” SMEI III, Open society for Albania “ OSFA “Organisation for Security and Cooperation in Europe” – OSCE.

Në organizimin e këtyre trajnimeve Institucioni ynë, ka qenë jo vetem partner por edhe koordinator në kuadër të bashkërendimit të trajnimeve. Kjo ka sjellë edhe një përdorim më racional të burimeve nga Buxheti i Shtetit, të cilat janë orientuar për trajnimet më të domosdoshme për Administratën Publike, në bazë të nevojave të tyre specifike.

Gjatë këtij viti, janë organizuar 32 kurse në bashkëpunim më projekte dhe donatorë, 62 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 640 nëpunës civilë.

E paraqitur grafikisht, pesha specifike e trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me këto projekte dhe donatorë, paraqitet si më poshtë:



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

✓ *Përdorimi i Teknologjise së informacionit dhe komunikimit (ICT) dhe përmirësimi i networkut për marketim.*

Edhe gjatë vitit 2013 i është kushtuar një rëndësi të veçantë mbajtjes dhe zhvillimi të kontakteve, me qëllim marrjen e informacionit dhe qëndrimin të përditësuar me zhvillimet si edhe me nevojat për trajnim. Nisur nga këto të dhëna është bërë e mundur organizimi i aktiviteteve trajnuese në përputhje me nevojat specifike për to.

Zhvendosja e ASPA disa herë gjatë vitit 2013, ka sjellë anomali në instalimin e linjës së internetit dhe vendosjes së kontakteve. ASPA është në procesin e krijimit të faqes së saj të internetit, në të cilën do të promovohen të gjitha shërbimet që ajo ofron, dhe që do të shërbejë si dritare për shpërndarjen e informacionit dhe marrjen e feedback-ut.

Ndërkohë në planet tona të mëtejshme një vend të veçantë do të zërë përdorimi i sistemit të email-it GoVNET për përhapjen e informacionit lidhur me trajnimin i cili do të jetë një hap shumë vendimtar në rritjen e aksesit të administratës publike për çështje që lidhen me trajnimet që ASPA ofron.

Programi i trajnimit për vitin 2013

Objekti kryesor i programit të trajnimit ka qënë:

Të mbështesë një shërbim civil më profesional, të aftë dhe të bazuar në sistemin e meritës, menaxher më të kualifikuar dhe më të përgjegjshëm si dhe një shërbim civil më cilësor dhe më të motivuar për të zbatuar strategjitë kombëtare për zhvillime të mëtejshme në të ardhmen.

Themelore për këtë program trajnimi është analiza e nevojave për trajnim. Konsultimi dhe mendimet e marra kanë bërë të mundur që programi i trajnimit të lidhet me së miri me nevojat e klientëve kryesore .

Procesi i Trajnimit

Programi i trajnimit për vitin 2013, ndarë sipas fushave të përcaktuara në Planin Strategjik, është realizuar duke u fokusuar më shumë në trajnimin e nëpunësve civilë të nivelit qendror, mbi çështjet që kanë lidhje me procesin e Integritit të vendit në BE.

1. Trajnime që lidhet me procesin e Integritit European

Vendi ynë në statusin e vendit kandidat për në Bashkimin European Ky proces shoqërohet me shumë reform dhe angazhime. Roli i ASPA-s është të mbështesë këto reforma dhe angazhime, duke rritur kapacitete e administratës publike shqipare, me qëllim rritjene efektivitetit të punës dhe rritje e cilësisë sidomos në fushën e aplikimi, menaxhimit dhe monitorimit të fondeve të BE-së.

Për të rritur kapacitetet e nëpunësve të Institucioneve qendore dhe lokale në programimin dhe zbatimin në të ardhmen të sistemit të decentralizuar të asistencës së BE-së, tashmë me një qasje të re sektoriale, janë organizuar trajnime për nëpunësit që punojnë me hartimin e



Adresa: *Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë*

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

projektpropozimeve, programimin dhe monitorimin e asistencës së BE-së. Pjesëmarrja e stafit të ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera qendrore në këto trajnime është një garanci më shumë për të patur projekte të mirëpërgatitura, duke plotësuar kështu edhe një kërkesë të BE-së: rritjen e pronësisë së përfituesve për programimin dhe menaxhimin me efektivitet të fondeve të IPA-s.

Në total janë zhvilluar 32 kurse, 62 dite trajnimi dhe janë trajnuar 640 nëpunës civilë, të nivelit qendror. Trajnimet e kësaj fushe kanë zënë rreth 39 % të totalit të trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2013.

2. Trajnime në mbështetje të strategjisë së decentralizimit

Qëllimi është të kontribuojë për zhvillimin e kapaciteteve të administratës lokale duke nxitur bashkëpunimin komunal nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira/modeleve që egzistojnë në vend. Në këtë fushë është punuar si me mbështetjen e buxhetit të shtetit, ashtu edhe me programe e projekte.

Bazuar në kërkesat dhe nevojat e qeverisjes vendore, është synuar të ofrohen për pjesëmarrësit njohuritë e nevojshme mbi administratën e qeverisjes vendore, trajnime me tematikë Asistencë teknike për administratën publike vendore në lidhje me përdorimin e nënshkrimit elektronik dhe dokumentit elektronik”, i cili u zhvillua me mbështetjen Fondacioni “ Shoqëria e hapur për Shqipërinë”- OSFA

Ky program trajnimi ishte shumë i dobishëm dhe një mënyrë mjaft efektiv, për arritjen e ndërgjegjësimit mbi mirëqeverisjen me ekspertizën e çertifikimit elektronik dhe dokumentit elektronik.

Ky ishte një trajnim dhe specifik që u implemetua për herë të parë nga institucioni ynë.

Aftësimi i administratës vendore me projektin e qeverisjes elektronike, siguron ofrimin e shërbimeve dhe veprimeve administrative përmes sistemeve elektronike duke ndërtuar një urë të shpejtë komunikimi ndërmjet administratës vendore në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër.

Një projeksim i tillë do të bëjë administratën publike me të qasshme, më të afërt dhe më transparente. Forcimi i transparencës, llogaridhënies, përgjegjësisë dhe reagueshmërisë së NJQV, kundrejt publikut duke përdorur nënshkrimin elektronik dhe dokumentin elektronik si pjesë operacionale do të mund ti ndërgjegjësojë institucionet vendore.

Kjo pakete trajnuese synoi informimin e pjesëmarrësve të administratës vendore me nënshkrimin elektronik dhe dokumentin elektronik si forma moderne, të shpejta, të sigurt, kualitative, në shërbim për të gjithë qytetarët, komunitetin e biznesit.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, në partneritet me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA , u organizuan 10 kurse trajnimi në nivel lokal.

Trajnimet u organizuan sipas hartës të shpërndarjes për të përfshirë gjithë qarqet e vendit dhe të gjitha nivelet qeverisëse, me një pjesëmarrje përfshirëse nga gjithë organogramat e strukturave të administratës vendore.

Një trajnim tjetër i cili u zhvillua në vitin 2013, ishte edhe trajnimi me temë “Procesi i vendimarrjes dhe menaxhimi i stafit”. Ky trajnim është organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Studimeve Politike (ASP), një program i Këshillit të Evropës, i mbështetur nga



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Fondacioni për një Shoqëri të Hapur për Shqipërinë (OSFA). Objektivi kryesor i këtij kursi ishte rritja e aftësive të nëpunësve të administratës vendore lidhur me praktikën vlerësuese për punonjësit dhe kanalet e duhura të komunikimit me qytetarët për vendimmarrjen, dhënien e njohurive lidhur me fondet europiane dhe procesi praktik i hartimit dhe aplikimit të projekteve; hartimi i strategjive të zhvillimit të njësive vendore etj.

Një tematikë tjetër e trajtuar për nivelin e administratës vendore është edhe trajnimi me temë “Prokurimi elektronik për blerjet e vogla”, me objektivi kryesor njohjen e nëpunësve me zhvillimit e reja në këtë fushë, si edhe me praktikën e zbatimit të kësaj procedure.

Gjatë vitit 2012, në nivelin vendor janë zhvilluar 32 kurse, 45 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 757 nëpunës civilë.

3. Trajnime të përgjithshme

Programi i trajnimit ofron njohuri mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike, procesin e hartimit të politikave dhe zbatimin efektiv të tyre, zhvillimin e aftësive menaxhuese të orientuara drejt rezultateve të nëpunësve civilë.

Prezantimi me Administratën Publike - ky program trajnimi, është i detyrueshëm për nëpunësit e sapoemëruar në administratë, dhe i njëj pjesëmarrësit me disa koncepte themelore mbi organizimin dhe funksionimin e administratës publike dhe shtetit Shqiptar, procedurat administrative, pa lënë mënjanë dhe aftësitë profesionale dhe menaxheriale që duhet të këtë nëpunësi civil në përputhje me kërkesat e kohës.

Gjatë vitit 2013 janë zhvilluar 2 kurse , 24 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 24 nëpunës civilë.

Në këtë fushë janë zhvilluar edhe trajnime si: Prokurimi elektronik për blerjet e vogla ; Mbrojtja e të dhënave personale; Hartimi i shkresave: Si të aplikojme për fonde te BE-së, të cilat janë trajnime të organizuara nga ASPA dhe të mbështetura plotësisht nga Buxheti i Shtetit.

Trajnime të përgjithshme për vitin 2013: Janë zhvilluar 37 kurse, 87 ditë trajnimi dhe janë trajnuar 874 nëpunës civilë.

Vlerësime dhe të Dhëna të Përgjithshme

Me zbatimin e Planit të Trajnimit për Vitin 2013 është synuar :

“Rritja e aftësive profesionale dhe përmirësimi i njohurive bazë të nëpunësve civilë, në mënyrë që secili prej tyre, në pozicionin përkatës, të përmbushë sa më mirë qëllimet e tij dhe të institucionit”,

dhe njëkohësisht, synimet e përcaktuara për vitin 2013:



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

1. Përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe funksionale të nëpunësve civilë në funksion të procesit të modernizimit dhe reformës në Shërbimin Civil të Shqipërisë.
2. Pajisjen e nëpunësve civilë me njohuri të mjaftueshme dhe aftësi përkatëse, me qëllim aplikimin efektiv të legjislacionit të përafëruar si dhe angazhimeve të marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit.
3. Përmirësimin e aftësive menaxhuese dhe profesionale të nëpunësve të administratës vendore, në mbështetje të reformave të ndërmarra në këtë administratë, nëpërmjet trajnimeve në përshtatje me prioritetet dhe nevojat përkatëse.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2013, u shënuan këto tregues për veprimtarinë trajnuese, në krahasim me atë të planifikuar, si më poshtë:

Treguesit	
Numri i Kurseve	69
Ditë trajnimi të Zhvilluara	132
Pjesmarrës në trajnim	1631
Indikatori i Trajnimit: Nëpunës Civil x Ditë trajnimi	3120
Indikatori i Cilësisë së Trajnimit (shkallë 1-6)	5.7

Mbështetje Institucionale dhe Financiare

⇒ **Departamenti i Administratës Publike (Ministria e Brendshme)**

Gjatë vitit 2013, Departamenti i Administratës Publike ka miratuar në vijimësi planin e punës dhe programin e trajnimit dhe ka ndjekur veprimtarinë trajnuese të Institucionit duke dhënë sipas rastit, orientimet dhe udhëzimet e duhura.

Donatore dhe bashkëpunime me projekte

➤ **Delegacioni i Bashkimit Europian**

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, ka vazhduar bashkëpunimin me Delegacionin e Bashkimit Europian edhe gjatë vitit 2013. Eshtë nënshkruar memorandum mirëkuptimi me dy projekte të financuara nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, siç janë projekti PPF, e SMEI III në Ministrinë e Integritimit Europian me të cilat ka bashkëpunuar me sukses gjatë kësaj periudhe.

Në Bashkëpunim me projektin PPF (project Preparation Facility)she SMEI III ,anë zhvilluar trajnime me tematika si: Menaxhimi i ciklit të projektit dhe kuadri llogjik, Hartimi i termave të referencës; Zbatimi i projekteve të financuara nga BE, Procedurat e prokurimit (PRAG) sipas standarteve të BE; Monitorimi i programeve të financuara nga BE;; Poltikat Sociale dhe punësimi



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

kap 19; Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm ; Bujqësia dhe zhvillimi rural kapitulli 11; Monitorimi i projekteve të financuara nga BE; Levizja e lirë e punëtorëve Kapitulli 2; E drejta e pronësisë intelektuale kapitulli 7. Grupi i synuar i këtyre trajnimeve kanë qënë nëpunës civilë të administratës qendore dhe kanë shërbyer për aftësimin e administratës publike, për ta bërë atë më eficiente.

Këshilli i Europës:

Në periudhën Shtator-Tetor 2013, me mbështetjen e Këshillit të Europës, dhe Kooperacionit Zviceran u zhvilluan disa aktivite me qëllim “Mbështetje për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri”. Në këtë juadër u zhvilluan takime në 2 qarqe të vendit, lidhur me problematikat dhe risitë që sjell zbatimi i ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civilë “. Në këto takime theksi u vu në detyrimet ligjore që burojnë nga ligji i ri, problematikave që lidhen me trajnimin e detyrueshëm, mbështeten financiare për formimin dhe trajnimin e vazhduar, trupën e nëpunësve të lartë, analizën e nevojave për trajnim, trajnimeve për zhvillimin në karrier etj.

Qëllimi këtyre takimeve ishte krahas informimit edhe marrja e mendimeve në lidhje me zbatimin në praktikë të ligjit “Për nëpunësin civil”, kryesisht për njësitë e qeverisjes vendore, sidomos në komunat të cilat për herë të parë implikohen nga ky ligj.

Trajnim Trajnerësh

Me mbështetjen teknike të projektit të asistencës së BE-së për procesin e Integritimit në Bashkimin Europian (Faza III, SMEI 3), në bashkëpunim me Ministrinë e Integritimit Europian të Shqipërisë, Institucioni ynë është duke zgjeruar grupin e trajnerëve në fushën e BE-së, në zbatim të strategjisë së trajnimit 2011 - 2013. Në këtë kuadër, në Tetor të vitit 2012, u realizua faza e parë e këtij bashkëpunimi. Kjo fazë përfshiu thirrjen për aplikantë dhe përzgjedhjen e kandidatëve sipas kriterëve të përcaktuara nga ITAP dhe MIE.

Mbas shqyrtimit të të gjitha kandidatëve që shprehën interesin e tyre për t'u bërë trajnerë të ITAP-it, u përzgjodh një grup prej 16 kandidatësh. Ky grup i përzgjedhur mori pjesë në një trajnim të avancuar 4 ditor (trajnim trajnerësh), që përbën dhe fazën e dytë të këtij projekti. Trajnimi u organizua në datat 22-25 Janar 2013, në Budva, Mali i Zi, ku të gjitha shpenzimet e këtij aktiviteti u mbuluan nga projekti SMEI III.

Trajnerët e çertifikuar në këtë aktivitet, zhvilluan më pas dhe trajnime të organizuara me mbështetjen e projektit SMEI III, sipas kapitujve të BE-së.

Univeriteti Europian i Tiranës:

Gjatë periudhës Gusht- Dhjetor 2013, ASPA në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës dhe UET Center, mori pjesë trajnimi me temë: “ Rritja e kapaciteteve në zhvillimin dhe aksesimin e fondeve strukturore të BE-së” i cili u organizua me fondet e Qeverisë Hollandeze .



Adresa: *Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë*

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Pjesëmarrës në këtë trajnim, përfaqësues të ASPA dhe UET, morën njohuri mbi procesin e aplikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve të financuara nga BE. Këtij qëllimi i shërbeu edhe vizita një javore në Hollandë, ku pjesëmarrësit vizituan konkretisht projekte të aplikuara me fondet e BE-së, dhe shkëmbyen eksperiencat në këtë fushë.

➤ **Qeveria Bullgare**

Në datat 22-26 Prill 2013 u zhvillua seminari me temë "Rritje e kapaciteteve për vendet e Ballkanit perëndimor për tu përballur me sfidat e integritimit Europian". Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Ministrinë e Linjës, DAP dhe ASPA. Ky aktivitet u organizua nga Instituti Diplomatik Bullgar së bashku me Fondacionin Hanns Seidel. Projekti u mbështet nga Këshilli Europës dhe ADA.

Qëllimi kryesor i këtij seminari ishte shkëmbimi i eksperiencës dhe njohja me përvojën e Shtetit Bullgar, në përballjen me këto sfida.

➤ **Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë**

Me mbështetjen e GIZ, në kuadër të projektit "Mbështetje për Zbatimin e Legjislacionit Shqiptar të Përafuar me Legjislacionin e BE-së" gjatë vitit 2013 janë organizuar në një bllok trajnimesh për çështje që lidhen me politikën tregtare dhe me çështjet e Kapitullit 30 të Acquis: Marrëdhëniet e Jashtme.

Objekti i trajnimeve ishte thellimi i njohurive të nëpunësve të administratës publike rreth çështjeve që lidhen me politikën tregtare, në nivel kombëtar, evropian dhe multilateral me qëllim rritjen e aftësive, rritjen e performancës dhe cilësisë në kryerjen e detyrave.

Për të arritur harmonizimin me acquis-në e BE, ky projekt u fokusua në këshillimin dhe mbështetjen e grupeve të punës ndërminstrore për sa i përket ligjit ekonomik dhe acquis së tregut të përbashkët. Këto çështje i ndoqën 8 grupe pune të kryesuara nga METE.

Grupi i synuar ishin nëpunësit e nivelit ekzekutiv dhe specialistët e ministrive dhe autoriteteve të cilat ishin të përfshira në planifikimin, kordinimin dhe implementimin e ligjit (veçanërisht personelit të METE dhe anëtarëve të grupeve ndërminstrore nga ministritë/autoritetet e tjera).

Gjithashtu pjesë e bashkëpunimit ishte edhe realizimi i një Trajnimi Trajneresh për çështjet e politikave të përbashkëta tregtare dhe kapitullit 30-Politikat e Jashtme. Qëllimi i këtij trajnimi ishte përgatitja e një bërthame trajneresh të certifikuar, të cilët ITAP do ti përdorte për përgatitjen e kurrikulave dhe shpërndarjen e trajnimeve në këtë fushë, si nevojë e një kërkesë për kualifikimin të nëpunësve publik për përmbushjen e kërkesave të Acquis. Në përfundim të këtij kursi u certifikuan 11 trajnerë, të cilët do të përdoren në të ardhmen si trajnerë potencialë që do të kontraktohen nga ASPA, në trajnimet në këtë fushë.

➤ **Prezenca e OSBE në Shqipëri**

Gjatë vitit 2013, ka vazhduar bashkëpunimi me OSBE-në. Mbështetja e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) nga ana e OSBE-Prezenca në Shqipëri ka synuar krijimin e një



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

programi gjithëpërfshirës mbi çështjet e etikës e antikorrupsionit për vlerësimin e kurrikulës aktuale dhe impaktin e programit të trajnimit me synim ndërtimin e një programi trajnimi për grupe interesi të niveleve të ndryshme në administratën publike dhe zhvillimin e Termave të Referencës për këtë kurs trajnimi.

Për arritjen e këtij objekti, Prezenca e OSBE-së ka kontraktuar dy konsulentë afat-shkurtër në periudhën 7 Nëntor 2013 - 7 Shkurt 2014; një konsulent ndërkombëtar dhe një konsulent vendas, të cilët do të asistojnë Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim vlerësimin e situatës aktuale të kurseve me tematikë anti-korrupsionin dhe ngritjen e një programi trajnimi.

Në periudhën nëntor-dhjetor 2013 nga ana e ASPA, OSBE dhe dy ekspertëve janë mundësuar një seri aktivitete të cilat konsistojnë në:

- Analizimin e kuadrit ligjor lidhur me antikorrupsionin duke përfshirë etikën, parandalimin e konfliktit të interesit, të drejtën e informimit;
- Studimin dhe vlerësimin e kurrikulave të kurseve të trajnimit të përdorura deri tani si: “Etika dhe antikorrupsioni”, “E drejta për t’u informuar”, “Prokurimi publik me mjete elektronike”, “Parandalimi i konfliktit të interesave” dhe vlerësimin e impaktit të trajnimit tek pjesëmarrësit;

Për këtë qëllim janë organizuar një sërë takimesh me përfaqësues të- Departamentin e Administratës Publike (DAP), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Agjensinë e Prokurimeve Publike (APP), Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KMDP), Avokati i Popullit; *ekspertë* trajnerë të fushës së etikës dhe antikorrupsionit si edhe me *organizata ndërkombëtare* si: Këshilli i Evropës (KiE), UNDP dhe USAID, etj.

Projekti në vazhdimësi për vitin 2014 vlerësohet i rëndësishëm për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike pasi sjell si produkte një kurrikulë të re, zhvillimin e Termave të Referencës, si dhe një program trajnimi lidhur me çështje që kanë lidhje me antikorrupsionin.

Bashkëpunimi me Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare

ReSPA- Shkolla Rajonale e Administratës Publike

Instituti i Trajnimit të Administratës Publike edhe gjatë vitit 2013, ka vazhduar të bashkëpunojë i me ReSPA. Në këtë kuadër, pjestarë të stafit kanë marrë pjesë rregullisht në aktivitetet që ka organizuar kjo shkollë, që kanë ndikuar në zhvillimin e kapaciteteve të institucionit.

Konferenca e 1-rë rajonale e ReSPA për CAF-in u zhvilluan në datat 29-30 Janar 2013, në Danilovgrad, Mali i Zi. Kjo konferencë u inicua nga ReSPA, në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Qendrës Europiane të CAF (European CAF Resource Centre) në Institutin Europian të Administratës Publike (EIPA-Maastricht).

CAF (Kuadri i Vlerësimit të Përgjithshëm)

CAF (the Common Assessment Framework) është një rezultat i bashkëpunimit midis Ministrave të BE-së për Administratën Publike. Një version pilot u prezantua në Maj të vitit 2000 dhe versione të tjera të rishikuara u shfaqën në 2002 dhe 2006. Për këtë qëllim u krijua dhe qendra Europiane e CAF në EIPA, e cila punon ngushtësisht me rrjetin e anëtarëve nga vende të ndryshme. Që prej 10 vjetësh afërsisht 3000 organizata të sektorit publik në të gjithë Europën po



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

përdorin teknikat e menaxhimit të cilësisë për të përmirësuar performancën. Dhe CAF është një instrument i Menaxhimit të Përgjithshëm të Cilësisë, një metodë vetvlerësuese, hartuar vecanërisht për organizatat e sektorit publik, duke marrë parasysh dhe karakteristikat e tyre individuale.

Konferenca Rajonale Dy ditore paraqiti praktika nga organizata të sektorit publik të vendeve të Rajonit dhe të Europës, duke evidentuar përdorimin praktik, rezultatet e marra dhe mësimet e nxjerra. Kjo konferencë shërbeu si një platformë për të mësuar nga njëri tjetri, duke diskutuar dhe pikat e forta, vështirësitë e hasura, barrierat dhe sfidat në ta ardhmen. Në të morën pjesë rreth 50 përfaqësues nga organizata të ndryshme të sektorit publik të rajonit si dhe përfaqësues nga Komisioni European (Drejtorja e Përgjithshme e Zgjerimit) etj.

➤ **Financimi**

Për vitin 2013 Buxheti i shtetit i ka akorduar ASPA-s (i cili është vazhdim i buxhetit që në fillim të vitit i ishte akorduar ITAP-it) një fond total prej 38 241 000, E shprehur në vlera relative, shpenzimet për pagat zënë 52 %, Shpenzime operative dhe trajnimi 19 %. Investime 27 % dhe Shpenzime të tjera (Kuotizime dhe transfertat) 2 %.

ASPA në muajin Korrik 2013 u zhvendos në mjediset e caktuara me VKM Nr. 786 datë 14.11.2012. Me një fond prej 7.8 milion lekesh nga buxheti i shtetit, u bë rikonstrukcioni i dy kateve të para të ndërtesës, dhe me një fond prej 2.8 milion lekë, u realizua mobilimi i 6 sallave të trajnimit dhe pajisja e tyre me mjete të teknologjise së informacionit për zhvillimin e trajnimeve.

Realizimi i këtyre shpenzimeve ishte në funksion të zhvillimit në kushte optimale të trajnimit të thelluar të nëpunësve civilë, që do të jenë pjesë e Trupës së Nivelit Drejtues (drejtorë të përgjithshëm, sekretarë të përgjithshëm), zhvillimit të programeve të trajnimit të vazhdueshëm, që ofron trajnim gjatë punës për nëpunësit civilë të të gjitha niveleve dhe administratën publike në përgjithësi, përgatitjen paraprake të kandidatëve që synojnë të hyjnë në shërbimin civil; zhvillimit të kurrikulave të trajnimit dhe organizimin e trajnimeve për staf të përzgjedhur të ministrive të linjës në përgjigje të sfidave të integritit evropian dhe të procesit të aderimit në BE, organizimin e ëorkshopeve dhe konferencave në mbështetje të reformave të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare, fokusuar në Reformën .

Aktualisht ASPA është zhvendosur në ambiente të reja, dhe përshtatja e këtyre ambienteve me nevojat e ASPA-s do të kërkojë që gjatë vitit 2014, një pjesë e buxhetit të alokohet për këtë qëllim.

📍 **Menaxhimi financiar**

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, për vitin 2013 aktivitetin ekonomik - financiar e mbështeti në të ardhurat nga Buxheti i Shtetit. Përdorimi i fondeve u bë në përputhje me Planin e Punës të Shkollës dhe në bazë të udhëzimit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

Realizimi i treguesve financiarë për vitin 2013, paraqiten në tabelën e mëposhtëme

000/ lekë

<i>Zërat e Buxhetit</i>	<i>Plani 2013</i>	<i>Realizimi 2013</i>	<i>Realizimi %</i>
600 Shpenzime Paga	17 197	16 542	94.1%
601 Sigurime Shoqërore	2 834	2.600	86.3%
602 Shpenzime operative	3 532	3 526	100 %
605 Shpenzime kuote	25	0	0%
231 Shpenzime AQ të trupëzuara	10579	10.391	98.22%
Total	34241	33126	93.72%

Sikurse shihet edhe nga të dhënat e mësipërme, gjatë vitit 2013, niveli i lartë i disbursimit të fondeve në masën 93.72 %, në funksion të aktiviteteve trajnuese.

Arritjet kryesore gjatë vitit 2013

- ⇒ Ka vazhduar bashkëpunimi i sukseshëm me donatorë gjatë vitit 2013, duke forcuar rolin e ASPA-s, si institucioni i besueshëm dhe i qëndrueshëm.
- ⇒ Financimet e donatorëve janë përdorur drejtpërdrejt për zhvillimin e trajnimeve në përputhje me nevojat e administratës publike fushën e trajnimeve për Integrimin Europian
- ⇒ Janë realizuar trajnime mbi Prokurimin elektronik të blerjeve të vogla, një prioritet i Qeverisë Shqiptare në luftën kundër korrupsionit.
- ⇒ Është rritur cilësia e shërbimeve ndaj klientit, që nënkupton rritje të cilësisë së trajnimit, materialeve trajnuese dhe komunikimit me klientët. Indikator i cilësisë së trajnimit (në një shkallë nga 1 në 6) u identifikua në shkallën 5.7 Pjesëmarrja në tërësi në kurset e trajnimit u tejkalua. Në tërësinë e tyre kurset e trajnimit mesatarisht u frekuentuan nga rreth 23 pjesëmarrës për çdo kurs nga 12 të parashikuar.
- ⇒ Janë menaxhuar në mënyrë efektive fondet e buxhetit të shtetit, duke koordinuar dhe alokuar burimet, në funksion të realizimit të trajnimeve në përputhje me nevojat për trajnim të administratës publike.



Adresa: **Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë**

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al

- ⇒ ASPA ka marrë rolin koordinues të trajnimeve të realizuara me fondet e donatorëve të ndryshëm. Kjo ka sjellë rritjen e kapaciteteve organizuese, monitoruese dhe vlerësuese të ASPA-s .
- ⇒ Plani i trajnimeve është ristrukturuar, në përputhje me nevojat dhe bazuar në Analizën e Nevojave për Trajnim e konsultuar me të gjithë institucionet e Administratës Publike dhe me donatorët.



Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark Nr 31, Tiranë

Tel/Fax: +355 4 2271860

www.aspa.gov.al email: aspa@aspa.gov.al